



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT

Nr. 1354 Prot.

Tiranë, më 07.06.2017

URDHËR

Nr. 1354, Date 07.06.2017

Për

Zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 473, datë 01.06.2017 «Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës Shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017 »

Në mbështetje të ligjit nr. 8730, dt. 18.01.2001 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor“, i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Urdhërit të Ministrit të Drejtësisë nr. 3851, datë 08.05.2009 “Për Miratimin e Kodit të Etikës të Përmbartuesve Gjyqësorë Shtetërore dhe Privatë”, ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 473, datë 02.06.2017 «Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të Burimeve Njerëzore, Financiare dhe Logjistike të Administratës Shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017»,

URDHËROJ:

1.Marrjen masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, si në nivel qendror, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit, dhe në nivel vendor, Zyrat Vendore Përmbartimore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet e Kuvendit për vitin 2017, duke ndjekur dhe zbatuar aktet ligjore dhe nënligjore, punonjësit e shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror kanë të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:

- a) Punonjësve të shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror, gjatë periudhës së procesit zgjedhor i krijohen kushtet e nevojshme dhe i garantohet moscënimi i të drejtave dhe lirive themelore, kushtetuese, për të shprehur fjalën e lirë dhe për të marrë pjesë në veprimtari politike brenda kufizimeve dhe ndalimeve, të përcaktuara me dispozita të veçanta të legjislacionit në fuqi, që rregullojnë dhe janë të vlefshme gjatë këtij procesi zgjedhor.
- b) Punonjësit e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të Institucionit, ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo zgjedhore të një partie politike ose kandidati në zgjedhje.
- c) Punonjësi i Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror ka të drejtë të angazhohet si komisioner zgjedhor, në përbërje të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve, pasi të kenë

njoftuar paraprakisht me shkrim eprorin direkt dhe njësinë e personelit për këtë veprimtari dhe të ketë marrë leje me shkrim nga eprori direkt. Angazhimi si komisioner nuk duhet të ndikojë në përmbushjen e detyrave funksionale që punonjësi kryen.

- d) Punonjësit të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucionit, i ndalohet çdo lloj pjesëmarrjeje në veprimtari politike apo fushatë zgjedhore të një partie politike ose kandidati në zgjedhje.
- e) Punonjësit e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, gjatë pjesëmarrjes në veprimtari, në kuptim të nenit 37, të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar, ndalohet:
 - të bëjë fushatë për një subjekt zgjedhor;
 - të manifestojë me pankarta, parulla apo çdo mjet tjetër të shkruar dhe të ekspozuar publikisht;
 - të jetë protagonist në aktivitetet/veprimtaritë politike;

2. Punonjësit e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare a njerëzore, me qëllim favorizimin e një partie politike ose kandidati në zgjedhje.

3. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masat menjëherë për përgaditjen e një urdhëri për “Ngritjen e grupit të punës për monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017”, të cilët duhet të kenë për detyrë:

- monitorimin dhe garantimin e zbatimit të detyrimeve ligjore, për ndalimin e vënies në përdorim për subjektet zgjedhore të veprimtarisë së tyre institucionale, mjeteve, fondeve e materialeve të ndryshme, pronë e shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetërore, si dhe të burimeve njerëzore të këtij shërbimi, për zgjedhjet e Kuvendit të datës 20 Qershor 2017.
- të kontrollojë në mënyrë periodike veprimtarinë e nënpunësve në varësinë e tyre, me qëllim shmangien dhe parandalimin e nxitjes apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve të administratës shtetërore në veprimtari politike apo në mbështetje të një partie politike ose kandidati në zgjedhje.
- të verifikojë dhe analizojë të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me përdorimin e mjeteve, fondeve e materialeve të ndryshme, si dhe mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë institucionale, gjatë periudhës përpara fillimit dhe gjatë fushatës zgjedhore, në funksion të evidentimit të përdorimit ose jo të tyre për qëllime elektorale.

4. Të monitorojë zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga VKM-ja nr. 473, datë 01.06.2017 për të garantuar mospërdorimin e:

- burimeve njerëzore të institucionit në funksion të veprimtarisë së fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore, të regjistruara për këto zgjedhje, në zbatim të nenit 14, të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;
- fondeve të institucionit për veprimtaritë e fushatës zgjedhore, të regjistruara për këto zgjedhje;
- mjeteve dhe materialeve në inventar të institucionit për veprimtaritë e fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore, të regjistruara për këto zgjedhje;

- zhvillimit të fushatës zgjedhore në Drejtorinë e Përgjithsh
-
-
- me të Përmbarrimit dhe Zyrrat Vendore Përmbarrimore apo realizimit të propagandës politike në DPP dhe Zyrrat Vendore Përmbarrimore.
- veprimtarisë shtetërore për të favorizuar subjekte të caktuara zgjedhore;
- detyruar, në fushatë zgjedhore, të administratës së institucionit brenda ose jashtë orarit të punës.

5.Gjatë fushatës zgjedhore automjetet dhe si dhe karburanti, në përdorim të titullarit apo institucionit, ndalohen të përdorën për veprimtari të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore, të regjistruara në zgjedhje.

6.Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në zbatim të pikës 14, të VKM-së nr. 473, datë 01.06.2017, të marrë masat menjëherë për të publikuar e e-mail në faqen zyrtare të internetit, duke bërë njoftimin për denoncimin e çdo rasti të përfshirjes ose nxitjes apo kërkesës për përfshirjen e punonjëseve të administratës shtetërore në veprimtari politike apo në mbështetje të një partie politike ose kandidati në zgjedhje.

7.Të konfirmohet menjëherë marrja dijëni e urdhërit nga secili punonjës i shërbimit përmbarrimor gjyqësor shtetëror dhe të dërgohet në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarrimit.

8.Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Inspektimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarrimit si dhe 22 (njëzet e dy) zyrrat vendore përmbarrimore.

9.Urdheri nr. 1075 prot., datë 24.05.2017, i Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarrimit, «Për ndalimin e vënies në përdorim për subjektet zgjedhore të mjeteve, fondeve dhe materialeve të ndryshme, pronë e shërbimit përmbarrimor gjyqësor shtetëror, si dhe burimeve njerëzore të këtij shërbimi të çdo niveli, për zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 Qershor 2017», dhe Urdheri nr. 1104/1 prot., datë 29.05.2017 «Për monitorimin e sjelljes së punonjëseve të Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror, në nivel qendror dhe vendor, gjatë fushatës për zgjedhjet e kuvendit të datës 25 Qershor 2017 », shfuqizohen.

10.Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Saimir XHUGLINI

